



Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria për Shërbime Publike

06.01.2023

Komisioni vlerësues i formuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër 01 nr. 263/22 të datës 27.01.2022, duke u bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të Rregullores nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, vendimit paraparak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme 01 nr. 359/19 të datës 26.12.2019, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2009-PK për mënyrën e zhvendosjes merr vendim për shpalljen e:

NJOFTIMIT PËR ANKAND PUBLIK PËR SHËRBIMIN E TRANSPORTIT ME AUTOMERIMANGË

Me këtë njoftim ftohen të gjithë të interesuarit që të shfrytëzojnë të drejtën e aplikimit në ankandin për marrje në shfrytëzim të shërbimit të transportit me auto-merimangë në pronën e paluajtshme komunale.

1. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim së bashku me shërbimin e transportit me auto-merimangë gjendet në:

- Pronën e paluajtshme në Komunën e Vushtrrisë në parcelën kadastrale P-70202010-00583-1 me sipërfaqe prej 10057 m², Z.K. Bukosh.

2. Afati për dhënie në shfrytëzim të pronës:

- Afati për dhënie në shfrytëzim të pronës së bashku me shërbimin e transportit me auto-merimangë do të jetë afatshkurtër, deri në dy (2) vite.

Qëllimi:

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër është:

1. Dhënia në shfrytëzim të shërbimit të transportit me auto-merimangë, për bartjen dhe transportin e mjeteve motorike të parkuara në kundërshtim me rregullat e trafikut.
2. Përfitimi ekonomik i komunës përmes dhënies në shfrytëzim.

Kushtet e veçanta:

- a) Çmimi në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2009-PK për mënyrën e zhvendosjes së mjeteve, është:
 - për tërheqjen e automjeteve 30 €.
 - për tentativë për tërheqjen e automjeteve 15 €.
- b) Zgjidhet oferta me çmimin më të lartë të ofruar për komunën.

Kriteret tjera:

1. Të ketë së pakut dy (2) automjete për bartjen e automjeteve,
2. Të ketë sistemin funksional të radio-lidhjeve,
3. Të sigurojë shërbimin 24 orësh, shtatë (7) ditë në javë,
4. Të ketë lidhje telefonike,
5. Të ketë numër të mjaftueshëm të personelit për ushtrimin e veprimtarisë (për një automjet për bartje), të ketë ngasësin dhe ndihmësin.
6. Komuna, në rast nevojë për interes publik, rezervon të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës me përfituesin e përkohshëm të pronës, pa obligim të kompensimit të investimeve të bëra.
7. Komuna, 3 (tre) muaj para ndërprerjes së kontratës, do ta njoftoi me shkrim shfrytëzuesin e përkohshëm, në rast të ndonjë vendimi që do të ndërlihet me pikën 6 të kriterëve të konkurrimit.
8. Veprimtaria e deklaruar me shkrim prej aplikuesit përfitues nuk mund të ndërrohet pa pëlqimin paraprak të organi kompetent të komunës – Kuvendit Komunal në Vushtri.
9. Është e ndaluar rreptësisht dhënia tjetrit me qera të pronës – objektit. Mosrespektimi i këtij kushti paraqet bazë për ndërprerjen e menjëhershme dhe të njëanshme të kontratës.
10. Automjetet duhet:
 - Të jenë të regjistruara.
 - Të jenë të dedikuara posaçërisht për bartjen e automjeteve, (njëri automjet duhet të jetë me vinç të ketë katër mungenet të cilat duhet të vendosen në rrota të automjetit, kurse tjetri duhet të jetë me litar tërheqës (metalik) që ta bëjë ngarkimin e veturave.

- Të dy automjetet të kenë xhoker nga dy (2) copa për automjetet automatike dhe automjetet (4 x 4).
- Viti i prodhimit të automjetit- gjendja teknike e automjetit dhe mekanizmit.
- Të jenë teknikisht në gjendje të rregullt në çdo kohë.
- Të kenë pajisjet e parapara për ushtrimin e kësaj veprimtarie.
- Të kenë dritën rrotulluese me ngjyrë të verdhë të vendosur mbi automjet dhe
- Të kenë shenjat përkatëse të komunikacionit.

Kushtet për drejtuesit e automjeteve

1. Drejtuesit e automjeteve duhet:
 - Të jenë punëtorë të operatorit (dëshmohet me kontratë pune).
 - Të kenë patentë shoferin e kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit gjegjësisht.
 - Të kenë ndihmësin për kryerjen e bartjes, zhvendosjes së mjetit.

Kushtet e përgjithshme të ankandit:

1. Afati për dhënie në shfrytëzim të pronës së bashku me shërbimin e transportit me automerimangë do të jetë afatshkurtër, deri në dy (2) vite për tërheqjen e automjeteve 30 €.
2. Personat të cilët marrin pjesë në këtë procedurë ofertës duhet bashkangjitur këto dokumente: (Certifikatën që është i regjistruar si biznes për ushtrimin e shërbimit të transportit me "merimangë", Vërtetimin e ATK-së për kryerjen e obligimeve tatimore dhe Vërtetimin e Tatimit në Pronë (që nuk ka detyrime të papaguara).
3. Letërnjoftimi valid i themeluesit të Op. Ek.
4. Një Deklaratë e shkruar dhe nënshkruar në të cilën, aplikuesi, Autoritetin Kontraktues sqaron mbi qëllimin dhe aktivitetin ekonomik që do ta ushtroi në pronën komunale për të cilën ka dorëzuar ofertën.
5. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit është 15 ditë nga dita e publikimit në ueb faqen e komunës dhe në vendet publike. Ofertat me dokumentacionin e plotësuar duhet të dorëzohen të mbyllura (në pliko) në zyrën pritëse në Komunën e Vushtrrisë nga data 06.01.2023 deri më 23.01.2023 në ora 15:00 dhe të të protokollohet nga komuna.
6. Vendi dhe koha për mbajtjen e ankandit është objekti i Komunës së Vushtrrisë rr. "Isa Boletini" nr.44, kati i I-të, zyra nr.31 më datën 27.01.2023 në ora 10:00.
7. Procedurat e ankandit mund të zhvillohen edhe në rastin kur paraqitet vetëm një ofertues me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kriteret e tjera të plotësuar.
8. Vlerësimi i ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës. Komisioni vlerësues brenda tre ditësh pas mbylljes së njoftimit publik, fton për hapjen e ankandit dhe vlerësimin e ofertave. Kryesuesi i komisionit pasi vëritet se nuk ka konflikt interesi nga ai dhe anëtarët e komisionit, në prani të ofertuesve, bën hapjen e ofertave ku identifikohen të gjitha çmimet

e ofertuesve. Pas vlerësimit të ofertave në ankand publik, komisioni vlerësues harton raportin përfundimtar dhe përzgjedh ofertën fituese.

9. Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtoj ankesë pranë „Komisionit për ankesa” në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së njoftimit në ueb faqen e komunës.
10. Kontrata për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme dhe shërbimit të transportit me auto-merimangë, nënshkruhet nga kryetari i komunës dhe fituesi i zgjedhur, pas rekomandimit nga komisioni.



Benjamin Shala

Kryesues i Komisionit Vlerësues